

Raporti Vjetor 2015



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

Përmbajtja

MISIONI DHE QËLLIMI I ZYRËS SË KOMISIONERIT	4
1. E DREJTA E INFORMIMIT	6
1.1 Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”	6
Trajtimi i ankesave	6
Hetime administrative	6
1.2 Monitorimi i Ligjit për të Drejtën e Informimit	8
1.3 Aktivitete mbi të drejtën e informimit	9
1.4 Implementimi dhe përfitimi i projekteve	11
Projekti me SOROS	11
Ndërtimi i portalit online	11
Projekti me SIGMA/OECD	12
Reforma në administratën publike dhe financimi buxhetor	12
Strategjia antikorruption dhe financimi buxhetor	12
Projekti i binjakëzimit në kuadër të strategjisë antikorruption	12
2. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE	13
2.1 Trajtimi i ankesave	13
2.2 Hetime administrative	14
2.3 Njoftimi	16
2.4 Transferimi ndërkombëtar	17
2.5 Rekomandime/Urdhra	18
2.6 Standarde unifikuese në sektorë të veçantë	19
Rekomandim në sektorin bankar	19
Monitorim i marketingut të drejtëpërdrejtë/sektori Call Center	19
Rekomandim për kontrolluesin ERE	20
2.7 Sanksione administrative	20
2.8 Proceset gjyqësore	22
2.9 Dhënie mendimi për projekt/akte ligjore dhe nënligjore	23
2.10 Monitorimi i Fletoreve Zyrtare 2015	25
2.11 Ndërgjegjësimi	25
2.12 Bashkëpunimi	26
Marrëdhënia me Ministrinë e Drejtësisë për anonimizimin e vendimeve gjyqësore	26
Marrëdhënia me Ministrinë e Punëve të Brendshme	27

Marrëdhënia me sektorin gjyqësor.....	27
Marrëdhënia me AKEP	27
Marrëdhënia me Avokatin e Popullit.....	27
2.13 Marrëveshje Bashkëpunimi	27
Marrëveshje Bashkëpunimi mes Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Autoritetit Italian të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (Il Garante per la protezione dei dati personali)	28
Marrëveshje Bashkëpunimi mes KDIMDP dhe AMA	28
Marrëveshje Bashkëpunimi mes KDIMDP dhe ILDKPKI	28
Marrëveshje Bashkëpunimi mes KDIMDP e QKR dhe KDIMDP e QKL	29
Publikimi i Vendimeve në faqen online të QKR-së, etj.....	29
2.14 Raportime	30
2.15 Bashkëpunimi Ndërkombëtar.....	30
Takimi i 17-të i CEEDPA	30
Takimi i 27-të i Punës për Trajtimin e Praktikave të Veçanta - Case Handling Workshop	30
Marrëdhënia me EUROJUST	31
Pjesëmarrje në Konferencën Evropiane.....	31
Pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare	32
Zyra e Komisionerit merr statusin e vëzhguesit në GP29.....	32
Zyra e Komisionerit anëtarësohet në Grupin Ndërkombëtar të Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacione (Grupi i Berlinit - IWGDPT).....	32
Angazhimi në rrjetin GPEN.....	33
Procedura për certifikimin e Shqipërisë si vend me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.	33
Mbështetje e Instrumentit TAIEX	33
3. NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK.....	34
4. MENAXHIMI BUXHETOR	34
4.1 Menaxhimi i burimeve njerëzore	34
4.2 Menaxhimi financiar	34
5. PROBLEMATIKA.....	38
6. SFIDAT PËR VITET 2016 – 2018.....	39

MISIONI DHE QËLLIMI I ZYRËS SË KOMISIONERIT

Mbrojtja dhe garantimi i dy të drejtave themelore, e drejta për informim dhe ruajtja e privatësisë janë mision i punës së Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (*KDIMDP*).

Qëllimi kryesor i aktiviteteve të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është të nxisë përputhshmërinë e sektorit publik dhe privat me mbrojtjen e të dhënave personale, të garantojë të drejtën e informimit dhe transparencën e Autoriteteve Publike.

Zyra e Komisionerit organizon aktivitete ndërgjegjësuere periodike, ofron ekspertizë me qëllim optimimin e standardeve të mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë si dhe përshtatjen e tyre me zhvillimet e shpejta teknologjike.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në funksion të kompetencave të tij, kryen hetime administrative dhe ka të drejtën e aksesit në përpunimet e të dhënave personale, duke sanksionuar administrativisht rastet flagrante të shkeljes së ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Zyra e Komisionerit është angazhuar edhe në bashkëpunimin ndërkombëtar, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive dhe kryerjes së aktiviteteve, shkëmbimit të informacionit, etj.

Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u themelua në vitin 2008, pas miratimit të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në vitin 2014, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke i caktuar autoritetit një kompetencë të re dhe duke e shndërruar atë në Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Zyra e Komisionerit monitoron procesin e funksionimit të Programeve të Transparencës së autoriteteve publike, në përputhje me dispozitat ligjore. Komisioneri shqyrton ankesat në lidhje me të drejtën për akses në informacionin publik.

Së fundi, me miratimin e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Zyra e Komisionerit shqyrton ankesat në lidhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj, pas miratimit të aktit.

▪ **Veprimtaria e punës në këtë vit raportimi është përqëndruar në;**

- Monitorimin e ligjit për të drejtën e informimit, trajtimin e ankesave, kryerjen e hetimeve administrative, rritjen e bashkëpunimit si dhe shprehjen e interesit për përfitim të projekteve në këtë fushë.
- Monitorimin dhe mbikëqyrjen e përpunimit të të dhënave personale, trajtimin e ankesave, rritjen e numrit të hetimeve administrative por edhe bashkëpunimin e vazhdueshëm.
- Forcimin e kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të marra brenda e jashtë vendit.
- Zhvillimin e kuadrit ligjor nëpërmjet dhënies së mendimeve për projektakte ligjore, nënligjore si dhe projektet.
- Konsolidimin e marrëdhënies me median dhe publikun për të krijuar kulturë gjithëpërfshirëse për informim dhe mbrojtje të privatësisë.
- Ndërmarrjen e iniciativave konkrete bashkëpunuese me kontrolluesin Media, si aktor i rëndësishëm në respektim të mbrojtjes së të dhënave personale.
- Bashkëpunimin me aktorët ndërkombëtarë.
- Ndërgjegjësimin e shoqërisë në tërësi.
- Menaxhimin me efektivitet të fondeve financiare.

1. E DREJTA E INFORMIMIT

1.1 Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Miratimi më 18 shtator të vitit 2014 i Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, synoi garantimin e informacionit për publikun në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të çdo individi në praktikë si dhe formimin e pikëpamjeve të publikut për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë, të nxisë integritetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike. Ky ligj në qëllimin e tij garanton rregulla konkrete për mbrojtjen dhe shndërrimin e të drejtës së informimit në një të drejtë reale dhe lehtësisht të zbatueshme në praktikë.


Trajtimi i ankesave

Duke filluar nga muaji Janar deri në fund të vitit 2015, pranë Zyrës së Komisionerit janë depozituar **274 ankesa** nga persona fizikë dhe persona juridikë lidhur me mosrespektimin dhe garantimin e së drejtës për informim, kryesisht me objekt “*Refuzim dhënie informacioni dhe kopje të dokumentave zyrtare*” ndaj autoriteteve publike. Në të shumtën e rasteve, autoritetet publike rezultojnë të mos kthejnë përgjigje kërkuarve.

Hetime administrative

Nga numri total i ankesave, janë dhënë **48 vendime** për pranim të objektit të ankesës, urdhërim të autoriteteve për të dhënë informacionin e kërkuar dhe rrëzim të ankesës, si dhe janë zhvilluar **2 seanca dëgjimore**. Zyra e Komisionerit ka realizuar **107 inspektive** pranë autoriteteve publike me synim verifikimin e ankesave të depozituara. Pas inspektiveve të kryera dhe dërgimit të kërkesave për parashtrim janë zgjidhur me ndërmjetësim **199 ankesa**, ndërsa **5 ankesa** kanë qenë të paplota, **3 ankesa** janë depozituar jashtë afatit dhe **19 ankesa** jashtë objektit të ligjit.

300 ankesa lidhur me zbatimin e ligjit nr. 119/2014




107 inspektive

Viti 2014
5 inspektive

Viti 2015
102 inspektive

50 vendime lidhur me mosrespektimin e ligjit nr.119/2014



274

Ankesa për vitin 2015

199	Ankesa të zgjidhura me ndërmjetësim
48	Me vendim të Komisionerit
19	Jashtë objektit të ligjit Nr.119/2014
5	Ankesa të paplota
3	Ankesa jashtë afatit

1.2 Monitorimi i Ligjit për të Drejtën e Informimit

Në kuadrin e zbatimit të monitorimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

- Është miratuar në përmbushje të nenit 6 dhe pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr. 119/2014 me Urdhrin e Komisionerit, nr. 14, datë 22.01.2015 “*Programi model i Transparencës për Autoritetet Publike*”, standardi i formatit “*Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve*” si dhe të tjerë dokumente rekomanduese për model, set i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të KDIMDP-së si dhe është botuar në *Fletoren Zyrtare nr. 6, datë 28 janar 2015*.
- Në përmbushje të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Komisioneri ka miratuar *Programin e Transparencës për KDIMDP-së*.
- Në përmbushje të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Zyra e Komisionerit ka krijuar dhe ka bërë publik regjistrin e kërkesave për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.
- Në përmbushje të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Komisioneri ka caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit .


Në kuadër të monitorimit të punës së autoriteteve për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Komisioneri ka urdhëruar kryerjen kryesisht të hetimeve administrative në 8 autoritete publike. Komisioneri ka vendosur **1** sanksion administrativ me gjobë për mospërmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në ligj.

Në mënyrë të vazhdueshme është bërë monitorimi i faqeve zyrtare të autoriteteve publike për të evidentuar publikimin e Programeve të Transparencës, caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit si dhe publikimin dhe përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Nga Autoritetet Publike janë caktuar **198** koordinatorë për të drejtën e informimit.

108 autoritete publike në total kanë miratuar dhe bërë publik Programin e Transparencës, prej tyre:

- 72 institucione qendrore
- 17 institucione të pavarura
- 4 sistemi gjyqësor/prokurori
- 5 pushteti vendor
- 2 shoqëri tregtare
- 8 të tjera



Nga monitorimi i vazhdueshëm i programeve të transparencës, Zyra e Komisionerit ka konstatuar që ka institucione të cilat nuk kanë hartuar programet e transparencës. Edhe ato institucione që kanë hartuar dhe miratuar programet e transparencës nuk i kanë të plota. Regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve janë të pa azhurnuar dhe ende ka institucione të cilat nuk kanë caktuar koordinatorët e të drejtës për informim.

1.3 Aktivitete mbi të drejtën e informimit

Për zhvillimin dinamik të këtij kuadri ligjor, Zyra e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ka kryer një sërë veprimtarish lidhur me zbatueshmërinë e Ligjit “Për të drejtën e informimit”.

- Në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (SOROS), u realizua trajnimi për koordinatorët e Autoriteteve Publike. Në këtë trajnim morën pjesë përfaqësues nga **150** autoritete publike, një pjesë e tyre ishin koordinatorë të së drejtës për informim ndërsa pjesa tjetër ishin titullarë institucionesh.

- Zyra e Komisionerit zhvilloi një vizitë pranë Autoritetit homolog të Malit të Zi, në kuadër të intensifikimit të procesit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërveprimit institucional në fushën e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit në shtetet respektive.
- Drejtoria për të Drejtën e Informimit mori pjesë në takimin “Balkans Open Government Partnership Dialogue 2015” i organizuar nga Ministri i Shtetit për Inovacion dhe Administratën Publike në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Gjithashtu, përfaqësues të drejtorisë morën pjesë edhe në takimin me temë “Identifikimi i sfidave dhe mundësive për aksesin në drejtësi të grupeve vulnerabël” i organizuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me UNDP-i Albania.
- Në zyrën e Komisionerit u zhvillua një trajnim me znj. Anamarija Musa, Komisioner për të Drejtën e Informimit të Kroacisë, në cilësinë e ekspertes së SIGMA (Support for Improvement in Governance and Management), organizëm i OECD-së (Organisation for Economic Co-operation and Development).
- Përfaqësues të zyrës së Komisionerit zhvilluan një vizitë studimore në autoritetin Skocez për të Drejtën e Informimit me qëllim shkëmbimin e eksperiencave në fushën e të drejtës për informim.
- Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – SOROS organizuan në Korçë konferencën rajonale “*E drejta për informim, autoritetet publike, koordinatori dhe programet e transparencës*”. Aktiviteti kishte për qëllim, që në kuadër të riorganizimit të organeve të qeverisjes vendore nga zbatimi i reformës administrativo-territoriale, të njihje dhe të trajnonte përfaqësuesit e këtyre strukturave, si dhe atyre të institucioneve qendrore në nivel vendor me detyrimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Në Podgoricë u përfaqësua në Konferencën e organizuar nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën për Informim e Malit të Zi në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të OSBE me temë “*E drejta për informim - eksperiencia rajonale dhe standardet ndërkombëtare në këtë vend*”.
- Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – SOROS organizuan në Vlorë konferencën rajonale “*E drejta për informim, autoritetet publike, koordinatori dhe programet e transparencës*”. Aktiviteti kishte për qëllim, që në kuadër të riorganizimit të organeve të qeverisjes vendore nga zbatimi i reformës administrativo-territoriale, të njihje dhe të trajnonte përfaqësuesit e këtyre strukturave, si dhe atyre të institucioneve qendrore në nivel vendor me detyrimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Në kuadër të projektit të përbashkët me SIGMA - organizëm i OECD-së u zhvillua në mjediset e Zyrës së Komisionerit trajnimi i dytë me znj. Anamarija Musa, Komisioner për të Drejtën e Informimit të Kroacisë dhe me ekspertin e SIGMA, Juhani Lemmik. Shkëmbimi i eksperiencës për konsolidimin e kapaciteteve administrative dhe aplikimin e praktikave më të mira në këtë fushë ishin në objekt të këtij aktiviteti.

- Zyra e Komisionerit ishte e ftuar dhe mbajti një prezantim në panelin kushtuar të “Drejtës për Informim” në Konferencën vjetore “Pushteti vendor dhe të drejtat e njeriut”, të organizuar nga institucioni i Avokatit të Popullit.
- Në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - SOROS u organizua në Shkodër konferenca rajonale *“E drejta për informim, autoritetet publike, koordinatori dhe programet e transparencës”*. Aktiviteti kishte për qëllim, që në kuadër të riorganizimit të organeve të qeverisjes vendore nga zbatimi i reformës administrativo-territoriale, të njihje dhe të trajnonte përfaqësuesit e këtyre strukturave, si dhe atyre të institucioneve qendrore në nivel vendor me detyrimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Drejtoria për të Drejtën e Informimit ka marrë pjesë në takimet e organizuara nga Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike për të raportuar mbi ecurinë e indikatorit për reformën në administratën publike si dhe strategjinë ndërsektoriale të reformës në administratën publike. Është raportuar mbi planin e veprimit të strategjisë kombëtare kundër korrupsionit 2015-2017 si dhe është duke u hartuar indikatori i cili do të jetë pjesë e dokumentit për financimin buxhetor që do të bëhet për strategjinë antikorrupsion.
- Me qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi mënyrën e plotësimit të kërkesës për marrjen e informacionit publik, Zyra e Komisionerit ka realizuar spot ndërgjegjëses i cili është publikuar në faqen zyrtare www.idp.al.

1.4 Implementimi dhe përfitimi i projekteve

Projekti me SOROS

Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit ka vijuar me implementimin e projektit që ka me Fondacionin SOROS. Janë realizuar trajnime me koordinatorët nëpër rrethe si dhe është hartuar komentari i ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Ndërtimi i portalit online

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me fondacionin SOROS janë duke ndërtuar portalin online për të drejtën e informimit në të cilin do të përfshihen koordinatorët por njëkohësisht do t'i krijohet mundësia çdo qytetari të depozitojë kërkesa dhe ankesa online. Realizimi i këtij projekti përkon edhe me Rezolutën e Kuvendit në të cilën është kërkuar krijimi i regjistrit të koordinatorëve. Portali do të administrojë Programet e Transparencës për të gjithë autoritetet publike si dhe shumë materiale sensibilizuese.

Projekti me SIGMA/OECD

Këtë vit ka filluar bashkëpunimi me SIGMA/OECD duke synuar rritjen e kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit. Janë realizuar dy trajnime të stafit nga Komisioneria Kroate si dhe është hartuar një material për përcaktimin e autoriteteve publike. Në bashkëpunim me SIGMA/OECD do të punohet për të hartuar një indikator i cili do të shërbejë si instrument për vlerësimin e punës së Autoriteteve Publike në lidhje me implementimin e ligjit.

Reforma në administratën publike dhe financimi buxhetor

E drejta për informim është bërë pjesë e strategjisë ndërsektoriale për reformën në administratën publike, e cila do të financohet nga Bashkimi Evropian. Në këtë strategji, Zyra e Komisionerit ka një indikator i cili mat numrin total të ankesave të depozituara si dhe numrin e sanksioneve/numrin e inspektimeve. Ky indikator do të shërbejë si një instrument për të monitoruar implementimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Strategjia antikorruption dhe financimi buxhetor

Gjithashtu e drejta për informim është pjesë e strategjisë antikorruption dhe në matricën e monitorimit të strategjisë, Zyra e Komisionerit ka dy masa për të cilat duhet të raportojë në mënyrë të përhershme. Konkretisht për krijimin e strukturave të nevojshme për zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit” si dhe ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”. Strategjia antikorruption do të mbështetet nga Bashkimi Evropian nëpërmjet financimit buxhetor.

Projekti i binjakëzimit në kuadër të strategjisë antikorruption

Zyra e Komisionerit do të jetë pjesë e projektit të binjakëzimit midis Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe një prej konsorciumeve që do të përzgjidhet në fund të janarit. Ky projekt binjakëzimi do të nisë të zbatohet gjatë vitit 2016 dhe do të zgjasë 30 muaj.

2. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Zhvillimi i veprimtarisë së punës në këtë drejtim është parë në këndvështrim të rritjes së numrit të inspektimeve dhe riinspektimeve me tematikë në sektorë të ndryshëm që mbledhin e përpunojnë të dhëna personale.

Është synuar, monitorimi i zbatimit të udhëzimeve si dhe rekomandimeve që janë dhënë për kontrollues publikë dhe privatë pas procesit të hetim-inspektimeve.

Vëmendje i është kushtuar bashkëpunimit me AKEP-in, lidhur me monitorimin e procesit të shkatërrimit të të dhënave personale të shtetasve, nga kompanitë mobile, si një detyrim që buron për kompanitë nga ligji për komunikimet elektronike.

Në objekt të punës ka qenë edhe monitorimi i procesit të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave, kryesisht në sektorë strategjikë si telefoni, banka, në funksion të mbrojtjes më të mirë të të dhënave personale të qytetarëve.

Nënshkrimi i disa marrëveshjeve të bashkëpunimit është tregues i rritjes së performancës institucionale duke përfshirë në punën e saj dhe ndarë atë edhe me aktorë të tjerë në kuadër të reciprocitetit.

2.1 Trajtimi i ankesave

Gjatë vitit 2015 janë paraqitur rreth **140** ankesa. **88** prej tyre kanë rezultuar në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe janë trajtuar nga Zyra e Komisionerit.

Për zgjidhjen e drejtë dhe të plotë të ankesave janë zhvilluar sipas rastit inspektime administrative pranë kontrolluesve të ndryshëm dhe janë ndjekur të gjitha hapat procedurale si komunikim i vazhdueshëm me subjektet ankues dhe kontrollues në kuadër të mbledhjes së informacionit.


Ankesat i kanë takuar kryesisht:

- Marketingut të drejtpërdrejtë, si numri më i madh i ankesave dhe kryesisht për komunikimet e pakërkuara, nëpërmjet telefonit ose postës elektronike;
- Publikimit të të dhënave personale në media dhe në faqet zyrtare në internet të kontrolluesve;
- Ushtrimit të të drejtës për akses të subjekteve për korrigjim/fshirje të të dhënave personale;
- Publikimit të të dhënave personale të paanonimizuara në vendimet gjyqësore, etj.

Edhe gjatë këtij viti, një numër i konsiderueshëm ankesash janë paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nëpërmjet postës elektronike të vendosur në dispozicion të subjekteve të të dhënave info@idp.al. Kjo ka bërë të mundur komunikimin e shpejtë edhe të drejtpërdrejtë me subjektet, duke lehtësuar procedurën dhe kohëzgjatjen e zgjidhjes së ankesave.


Gjatë vitit 2015 janë paraqitur
140 ankesa.

Prej të cilave, **88** kanë rezultuar objekt i ligjit për mbrojtjen e të dhënave dhe janë trajtuar nga Zyra e Komisionerit.



Krahasim me vitin e mëparshëm

■ Ankesa të trajtuara □ Ankesa jashtë objektit të ligjit Nr.9887




2.2 Hetime administrative

Gjatë vitit 2015, është synuar rritje e numrit të inspektimeve dhe riinspektimeve me tematikë në sektorë të ndryshëm. Për këtë është hartuar plani vjetor i punës dhe pjesa më e madhe e hetimeve


administrative janë parashikuar tematike dhe sektoriale. Sektorët kryesorë ku janë ushtruar inspektime janë:

- Sektori bankar;
- Sektori marketing (call center);
- Sektori arsimor (inspektime mbi bazë ankesash dhe inspektime online);
- Media (inspektime mbi bazë ankesash);
- Videosurvejimi - CCTV;
- Hoteleri-Turizëm;
- Autoritete Publike (Ministritë);
- Telekomunikacion, (procesi i shkatërrimit të të dhënave personale);
- Pushteti vendor (inspektime online dhe mbi bazë ankesash).

Në këtë kuadër, janë kryer **169** hetime administrative, kryesisht por edhe mbi bazë ankese. Hetimet administrative janë realizuar kryesisht në kontrollues me seli në Tiranë, por edhe në disa rrethe të tjera të vendit, si Durrës, Fier, Vlorë, Berat dhe Shkodër. **48** kanë qenë inspektime online të realizuara në sektorin e pushtetit vendor (**29**) dhe sektorin arsimor (**19**). Njësitë e qeverisjes vendore ofrojnë një spektër të gjerë shërbimesh ndaj qytetarëve që përfshijnë përpunimin e të dhënave personale. Këto shërbime ofrohen nëpërmjet proceseve që përfshijnë mbledhjen, grumbullimin dhe komunikimin e të dhënave personale. Inspektimet janë realizuar gjatë muajit dhjetor, ndërsa është duke u përpunuar informacioni i mbledhur dhe në vijim Zyra e Komisionerit do të shprehet me akt përfundimtar.



Hetimet administrative janë realizuar kryesisht në kontrollues me seli në Tiranë, por, edhe në disa rrethe të tjera të vendit, si Durrës, Fier, Vlorë, Berat dhe Shkodër.



2.3 Njoftimi

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë e cila për vitin 2015 kërkoi *“Angazhimin maksimal të Komisionerit, në drejtim të një identifikimi sa më të plotë të subjekteve kontrolluese e përpunuese dhe regjistrimit të tyre në regjistrin e subjekteve kontrolluese”*, për këtë vit puna e Zyrës së Komisionerit është vlerësuar në identifikimin e subjekteve kontrolluese e përpunuese të mëdha, duke synuar kategori të njëjta subjektsh, me qëllim sensibilizimin dhe regjistrimin e plotë të tyre.


Në këtë kuadër, është kryer verifikim i hollësishëm për gjendjen e kompanive me objekt veprimtarie “Call Center”, duke siguruar informacionin e nevojshëm nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit për të gjitha subjektet kontrolluese të cilat kanë deklaruar se ushtrojnë aktivitet në këtë fushë.

Gjatë këtij viti, në përmbushje të detyrimit ligjor për të njoftuar ka pasur rritje të numrit të njoftimeve nga kontrolluesit e mësipërm, të telefonatave por edhe të takimeve në ambientet e zyrës me përfaqësuesit e tyre. Kjo ka ardhur si rezultat i një sërë verifikimesh të kryera në këto subjekte, të cilët kanë detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunojnë, por edhe nga sensibiliteti i krijuar pas vendimeve për sanksion administrativ-gjorbë për disa prej tyre, të cilët iu nënshtruan procedurës së hetimit administrativ.

Gjithashtu në objekt të punës tonë në drejtim të identifikimit dhe regjistrimit të kontrolluesve të mëdhenj kanë qenë dhe subjektet kontrolluese që ushtrojnë veprimtarinë në fushat e hotelieritizmit, qendrave tregtare si dhe kontrolluesve që përpunojnë të dhëna nëpërmjet sistemit të kamerave të vëzhgim-regjistrimit.

Si rezultat i strategjisë së re sensibilizuese, por edhe detyruese ligjore, të ndjekur gjatë kësaj periudhe pranë Zyrës të Komisionerit kanë njoftuar **450** subjekte kontrolluese të cilët janë kryesisht kontrollues të mëdhenj dhe përpunojnë të dhëna për kategori të ndryshme subjektsh të të dhënave. Numri i përgjithshëm i njoftimeve të përpunimeve nga kontrolluesit në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në fund të vitit 2015 ka mbërritur në **5157**.

Kemi vijuar me regjistrimin dhe publikimin online në Regjistrin e Hapur për Publikun të njoftimeve që rezultojnë se kryejnë përpunimin e të dhënave personale konform kërkesave të neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Numri i subjekteve kontrolluese të regjistruara për këtë periudhë është **425**, duke e çuar numrin e subjekteve të regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Kontrolluese në **5090**.



2.4 Transferimi ndërkombëtar

Evidentohet numër në rritje i kërkesave për transferim ndërkombëtar të trajtuara nga Zyra e Komisionerit në krahasim me vitin 2014.

Edhe sipas kërkesës së Rezolutës së Kuvendit, në të gjitha rastet e kontrolleve administrative të realizuara në sektorin bankar gjatë vitit 2015 është monitoruar procesi i transferimit.

Gjithashtu, me indicie nga Formularët e Njoftimit, në rastet ku është konstatuar se realizohet transferim në vende me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave është kërkuar informacion shtesë nga kontrolluesit dhe janë shqyrtuar praktikatat përkatëse të transferimeve.


Janë trajtuar 9 praktika, për transferim ndërkombëtar të të dhënave për të cilat është dalë me 7 (shtatë) vendime,

- 1 vendim nuk lejon/autorizon transferim të dhënash;
- 3 vendime autorizojnë transferim të dhënash në mënyrë të kushtëzuar;
- 3 vendime autorizojnë transferim të dhënash;
- 1 praktikë është ende në proces shqyrtimi (kërkesa është paraqitur pranë KDIMDP-së në muajin dhjetor 2015).
- Për 1 praktikë janë dhënë orientime.

Gjatë vitit 2015 janë dhënë edhe mendime e orientime për kontrollues të ndryshëm në lidhje me transferimin ndërkombëtar në formë shkresore ose nëpërmjet postës elektronike, mbi bazë kërkesë nga ana e tyre.

PRAKTIKA TË TRAJTUARA PËR TRANSFERIM NDËRKOMBËTAR TË TË DHËNAVE PERSONALE	9
Është dhënë autorizim për transferim të dhënash personale	3
Është dalë me vendim mosdhënie të autorizimit	1
Është dhënë autorizim me kushte	3
Praktikë ende në proces shqyrtimi	1
Praktikë për të cilën janë dhënë orientime	1


Praktika të trajtuara për transferim ndërkombëtar të të dhënave personale



2.5 Rekomandime/Urdhra

Gjatë vitit 2015 Zyra e Komisionerit ka dalë me **37** Rekomandime për kontrollues publikë dhe privatë dhe me **2** Urdhra pezullimi të përpunimit të të dhënave personale. **17** Rekomandime janë dhënë për institucione publike dhe **20** rekomandime për subjekte private.

Në lidhje me monitorimin e përmbushjes së Rekomandimeve dhe Urdhrave, rezulton se pjesa më e madhe e kontrolluesve kanë njoftuar për përmbushjen e rekomandimeve të lëna në zbatim të detyrimit ligjor (neni 32 i ligjit). Janë realizuar verifikimet e duhura mbi bazë dokumentacioni dhe sipas rastit janë realizuar edhe verifikimet të tjera në terren. Në rast se pas verifikimit në terren ka rezultuar mospërmbushje e zbatimit të Rekomandimeve, Urdhrave, Zyra e Komisionerit në zbatim të përgjegjësiave ligjore ka vendosur sanksion administrativ me gjobë. Në këtë kuadër, gjatë këtij viti është dalë me **4** vendime me sanksion gjobë.



2.6 Standarde unifikuese në sektorë të veçantë

Rekomandim në sektorin bankar

Gjatë këtij viti Zyra e Komisionerit ka dalë me **Rekomandime** për sektorin bankar. Rekomandimet janë rezultat i hetimeve administrative të ushtruara nga Zyra e Komisionerit në këtë sektor. Hetimet janë realizuar mbi bazë ankesash nga qytetarë, por edhe kryesisht. Gjatë realizimit të procedurave janë evidentuar disa problematika në marrëdhëniet e këtyre institucioneve me klientët, por edhe me palë të treta. Për këto arsye, Zyra e Komisionerit ka vendosur t'u rekomandojë subjekteve kontrolluese në sektorin bankar, një seri ndryshimesh konkrete procedurale, për përmbushjen e dispozitave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Njëkohësisht, në lidhje me konstatimet, Zyra e Komisionerit ka dalë me rekomandim edhe për Bankën e Shqipërisë, në cilësinë e organit mbikqyrës të drejtpërdrejtë për të monitoruar zbatimin e dispozitave të ligjit për mbi ruajtjen e konfidencialitetit. Nga ana e Bankës së Shqipërisë janë marrë në konsideratë rekomandimet e Zyrës së Komisionerit.

Monitorim i marketingut të drejtpërdrejtë/sektori Call Center

Zyra e Komisionerit ka realizuar kontroll sektorial në subjekte kontrollues me objekt veprimtarie **call center**. Ka patur një numër të konsiderueshëm ankesash në këtë drejtim në kuadër të marketingut të drejtpërdrejtë. Në rastet kur, përveç shkeljeve serioze të konstatuara duke u bazuar në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, subjektet kryenin aktivitetin në fushën e brokërimit në kundësthim me ligjin nr 9879 datë 21.02.2008 “Për Titujt”, ligjin nr. 9752, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe me ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, Zyra e

Komisionerit ka vënë në dijeni edhe strukturat kryesore në zhvillimin dhe zbatimin e politikave si, ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ashtu dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Rekomandim për kontrolluesin ERE



Dhënia e Rekomandimit nga Komisioneri për Entin Rregullator të Energjisë (ERE), si autoriteti mbikëqyrës i ofrimit të këtij shërbimi ka disiplinuar këtë kontrollues në përpunimin e të dhënave në një drejtim të caktuar. Ky akt i ka propozuar këtij Autoriteti të miratonte ndryshime në Rregulloren nr. 22, datë 25.02.2012 “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes” lidhur me mënyrën e arkivimit të dokumentave të regjistrimit të pronësisë të përfituesve të energjisë elektrike. Në përmbushje të këtij Rekomandimi, ERE ka reaguar nëpërmjet vendimit nr.53, datë 17.04.2015 (botuar në fletore zyrtare) me të cilin miratoi ndryshimet në rregulloren përkatëse. Gjithashtu, parashikimet e reja kanë reflektuar edhe mbi ruajtjen e informacionit nga OSHEE, si veprim që duhet të realizohet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

2.7 Sanksione administrative

Gjatë vitit 2015 Zyra e Komisionerit ka dalë me **46** Vendime të cilat korrespondojnë me **54** sanksione administrative. Sipas parashikimeve dhe procedurave ligjore, Zyra e Komisionerit pas ushtrimit të hetimeve administrative pranë kontrolluesve të ndryshëm publik dhe privat, kryesisht ose mbi bazë ankesash të subjekteve të të dhënave ka vendosur sanksione me gjobë. Në rastet kur shkeljet kanë qenë serioze, të përsëritura, apo në rast mospërmbushjeje të Rekomandimeve/Urdhrave të Komisionerit. Pas shqyrtimit të materialeve përkatëse administruar në dosje, si rezultat i hetimeve administrative, në rastet ku janë konstatuar shkelje të ligjit, janë zhvilluar **seanca dëgjimore**. Seancat dëgjimore janë zhvilluar pasi kontrolluesit janë njoftuar paraprakisht dhe në respektim të të drejtës së subjekteve për t’u dëgjuar në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” përpara marrjes së vendimit përfundimtar me sanksion gjobë për kontrolluesin.

Gjatë vitit 2015 Zyra e Komisionerit ka dalë me **46** vendime gjobe

• të cilat korrespondojnë me **54** sanksione administrative





2.8 Proceset gjyqësore

Është vijuar me ndjekjen e procedurave gjyqësore në kuadër të ankimeve të depozituara nga kontrolluesit ndaj vendimeve të Komisionerit me sanksion/gjobë apo edhe ndaj urdhërimeve të ndryshme. Në çdo rast janë përgatitur dhe paraqitur prapësimet apo konkluzionet përfundimtare. Reciprokisht vijohet edhe me ndjekjen e procedurave të ekzekutimit të vendimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nga 20 procese gjyqësore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, 16 prej tyre kanë përfunduar së shqyrtuari. Për 15 është lënë në fuqi vendimi i dhënë nga Komisioneri, ndërsa 1 proces vijon të jetë në shqyrtim mbi ankimin e paraqitur.

Në fushën e të drejtës për informim kanë përfunduar në shkallë të parë 3 procese gjyqësore mbi vendimet e Komisionerit, lidhur me urdhërimin e dhënies së informacionit në kuadër të ligjit “Për të drejtën e informimit”. 2 prej tyre do të shqyrtohen në gjykatën e Apelit Administrativ mbi ankimin e ushtruar nga autoriteti publik.





SHUMA E ARKËTUAR
NË BUXHETIN E SHTETIT PËR VITIN 2015
NGA EKZEKUTIMI I VENDIMEVE ME GJOBË
ARRIN VLERËN **4.580.000 LEKË**



2.9 Dhënie mendimi për projekt/akte ligjore dhe nënligjore

Zyra e Komisionerit ka synuar nxitjen e subjekteve publike dhe private, për të dërguar pranë saj për mendim çdo projektakt ligjor e nënligjor, dokumente të ndryshme juridike, marrëveshje, etj, që kanë lidhje me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Për këtë, është shfrytëzuar çdo takim, çdo raportim, çdo trajnim apo edhe çdo dalje publike.

Integrimi i legjislationit të brendshëm me atë të mbrojtjes së të dhënave personale përbën thelbin e procesit të përpunimit të drejtë e të ligjshëm të të dhënave. Krahasimisht me një vit më parë, shifrat tregojnë rritje të numrit të akteve për të cilët KDIMDP është investuar në dhënien e mendimeve. Janë adresuar për mendim 15 p/Ligje, 17 p/VKM si dhe 4 p/Udhëzime, etj.

Ndër to përmendim:

Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH” i ndryshuar, dërguar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 53/2014 “Për sigurimin e depozitave”, dërguar nga Ministria e Financave.

Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10128, datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike” të ndryshuar, dërguar nga Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Projektligjin “Për masat shtesë të sigurisë”, dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligjin “Për sinjalizuesit”, dërguar nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore.

Projektligjin “Për shoqëritë e Kursim Kreditit dhe Unionet e tyre”, dërguar nga e Ministria e Financave.

Projektligjin “Për regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligjin “Për kontrollin kufitar”, dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligjin “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, dërguar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, dërguar nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore.

Projektvendimin për miratimin e “Rregullores për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, dërguar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Projektvendimin “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm (PBA)”, dërguar nga Ministria e Financave.

Projektvendimin “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Borxhit dhe Analizës Financiare (DMFAS)”, dërguar nga Ministria e Financave.


Projektvendimin “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ)”, dërguar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Projektvendimin “Për Rregullat për funksionimin, krijimin, administrimin, formatin, përmbajtjen dhe procedurat për sigurinë e regjistrit të investimeve strategjike”, dërguar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Projektvendimin “Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike”, dërguar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Projektregulloren e mbrojtjes së të dhënave personale, dërguar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) si dhe është realizuar një takim mes përfaqësuesve të Zyrës së Komisionerit dhe AKEP-it në kuadër të hartimit dhe nënshkrimit të një marrëveshje bashkëpunimi për të cilën tashmë ka nisur puna.

- ✓ Gjithashtu janë dhënë opinione ligjore për disa dokumente të tjerë të rëndësishëm të ardhur nga institucione të ndryshme si për p/Strategji, p/Rregullore të kontrolluesve, etj.



- ✓ Faqja zyrtare e Zyrës së Komisionerit në një rubrikë të veçantë pasqyron dhënien e mendimeve për projektakte të dërguara për mendim.

2.10 Monitorimi i Fletoreve Zyrtare 2015

Në zbatim të përgjegjësiave të Komisionerit, të parashikuara në nenin 31/1/a të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, për të dhënë mendime për projektakte ligjore, nënligjore dhe projekte, është bërë verifikimi i Fletoreve Zyrtare për të pasqyruar sa prej akteve të botuara nuk janë dërguar për mendim.

Raportimi pasqyrohet në **Aneksin nr.1**, bashkëngjitur Raportit.

2.11 Ndërgjegjësimi

Zyra e Komisionerit i ka kushtuar vëmendje të veçantë ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të kontrolluesve dhe subjekteve të të dhënave mbi rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale. Gjatë kësaj periudhe raportimi, janë zhvilluar disa seminare trajnuese.

- Seminar i organizuar me sektorin bankar. Në këtë seminar janë trajtuar kryesisht ndryshimet e fundit ligjore dhe nënligjore, si dhe problematikat e ndryshme të ndeshura nga sistemi bankar në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Seminar trajnues 2-ditor me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në këtë Workshop u trajtuan çështje konkrete në lidhje me grumbullimin, përpunimin, arkivimin dhe standardet e sigurisë së të dhënave personale të shtetasve, përgjatë ushtrimit të funksioneve ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit.
- Seminar me sektorin e IT-së. Seminari në këtë rast ka qenë dedikuar "Cloud Computing"(CC) dhe masave të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale. Organizimi shërbeu për përfaqësuesit e kompanive të IT-së, bankave si dhe institucionet shtetërore për tu njohur kryesisht me udhëzuesin për Cloud Computing të miratuar nga Komisioneri.
- Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me Dhomën Kombëtare të Noterisë kemi zhvilluar trajnime të noterëve, me qëllim informimin e tyre mbi detyrimin ligjor për të njoftuar në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Zyra e Komisionerit ishte e pranishme me stendën e saj në Panairin e 18-të të Librit “Tirana 2015”. Kjo ishte pjesëmarrja e dytë radhazi në këtë aktivitet, si një tjetër kontribut me vlerë për të komunikuar sa më shumë dhe drejtpërdrejtë me publikun.
- Me qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre në rastet e marrjes së telefonatave (thirrjeve) të padëshirueshme, Zyra e Komisionerit ka realizuar spot ndërgjegjëses i cili është publikuar në faqen zyrtare www.idp.al.

2.12 Bashkëpunimi

Marrëdhënia me Ministrinë e Drejtësisë për anonimizimin e vendimeve gjyqësore

Për të bërë të mundur anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore të publikuara në faqen online të sistemit gjyqësor, Zyra e Komisionerit prej muajit mars në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë përfunduan një projektudhëzim për mënyrën e arritjes së këtij procesi. Në vijim të punës për arritjen e këtij qëllimi, i është kërkuar Ministrit të Drejtësisë vijimësia e bashkëpunimit mbi mënyrën e bërjes anonime të të dhënave personale në vendimet gjyqësore.

Marrëdhënia me Ministrinë e Punëve të Brendshme

Dhënia e mendimeve e projektakteve të rëndësishme të dërguara nga Ministria e Punëve të Brendshme, trajnimet e zhvilluara si dhe organizimi i disa inspektimeve pranë kësaj Ministrie identifikojnë punën e bërë në këtë sektor.

Marrëdhënia me sektorin gjyqësor

Ka nisur një bashkëpunim i mirë me Shkollën e Magjistraturës për të mundësuar trajnimin e gjyqtarëve në këtë fushë dhe gradualisht për të arritur përfshirjen e kurrikulave në aktivitetin mësimor të kësaj shkolle.

Marrëdhënia me AKEP

Bashkëpunimi me AKEP-in ka vijuar në dhënien e mendimeve, nisjen e punës për hartimin dhe nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi, takimet e realizuara, etj. Mbi kërkesën tonë për të zhvilluar inspektime të përbashkëta, AKEP ka ofruar ekspertizë në kryerjen e tyre.

Në këtë periudhë raportimi puna është përqendruar në monitorimin e procesit të shkatërrimit të të dhënave personale të shtetasve, nga kompanitë mobile, si një detyrim që kompanive u rrjedh nga ligji i AKEP-it. Ka nisur inspektimi administrativ pranë dy kontrolluesve në fushën e telekomunikacionit. Objekti i tij është zbatimi i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me monitorimin e procesit të shkatërrimit të të dhënave personale të shtetasve pas përfundimit të qëllimit të përpunimit të tyre nga operatori i telefonisë. Vijohet me këtë proces, konkluzionet e të cilit do të jenë pjesë e raportimit të ardhshëm.

Marrëdhënia me Avokatin e Popullit

Në përmbushje të detyrës së lënë në Rezolutën e Kuvendit, Zyra e Komisionerit nëpërmjet shkresës nr. 698 prot, datë. 21.07.2015 dërguar Avokatit të Popullit, ka vlerësuar interesin e përbashkët në hartimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me qëllim trajtimin e rasteve me objekt të drejtën e informimit.

2.13 Marrëveshje Bashkëpunimi

Gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar 5 Marrëveshje Bashkëpunimi. Rezoluta e Kuvendit për vitin 2014 por edhe Progres Raporti i BE-së për vitin 2015, në kërkesat e tyre kanë rekomanduar nënshkrimin e marrëveshjeve dhe rritjen e marrëdhënieve ndërinstitucionale të Zyrës së Komisionerit kryesisht në fushën e medias.

Në vëmendje ka qenë edhe bashkëpunimi ndërkombëtar, rezultat i të cilës ka qenë nënshkrimi i marrëveshjes me Autoritetin homolog Italian.

Marrëveshje Bashkëpunimi mes Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Autoritetit Italian të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (Garante per la protezione dei dati personali)

Në shkurt, Zyra e Komisionerit zhvilloi vizitë studimore pranë autoritetit homolog italian “Garante per la protezione dei dati personali”. Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i eksperiencës kryesisht në lidhje me procedurat e hetimit administrativ por edhe për çështje të tjera të rëndësishme lidhur me veprimtarinë e autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave personale. Dy Komisionerët nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi. Qëllimi i saj është nxitja e bashkëpunimit për shkëmbim të vazhdueshëm të eksperiencës në kryerjen e inspektimeve/mbikëqyrjeve të përbashkëta në kontrollues/kompani Italiane që ushtrojnë aktivitetet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përpunojnë të dhëna personale.

Marrëveshje Bashkëpunimi mes KDIMDP dhe AMA

Në mjediset e Zyrës së Komisionerit, më 23 shtator u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit me Autoritetin e Mediave Audiovizive. Ky dokument është një bazë solide për koordinimin e punës mes dy Autoriteteve tona në procesin e monitorimit të zbatimit të akteve ligjore në fushat respektive dhe në bashkëpunim të ndërsjellët. Marrëveshja i jep rëndësi të veçantë trajtimit në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës të të dhënave personale të qytetarëve nga ana e medias, por, njëkohësisht i nxit ato të ushtrojnë në mënyrë të balancuar të drejtën për informim.

Dokumenti parashikon ndër të tjera, koordinimin dhe bashkëpunimin e punës mes dy Autoriteteve në drejtime të tilla si, hartimin dhe rishikimin e programeve të transparencës; hartimin e kodit/kodeve të etikës të mediave audiovizive; të propozojnë përmirësime ligjore e nënligjore në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale; të nxisin sensibilizimin e opinionit publik me qëllim rritjen e ndjeshmërisë për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e mediave audiovizive; së bashku me shoqatat e subjekteve audio dhe audiovizuale, si dhe me shoqatat për mbrojtjen e fëmijëve, të rrisin përgjegjësinë dhe standardet profesionale të gazetarëve dhe punonjësve të tyre, në veprimtari të përbashkëta, për eliminimin e rasteve të shkeljeve të të dhënave personale të të miturve në programet audio dhe audiovizive.

Marrëveshje Bashkëpunimi mes KDIMDP dhe ILDKPKI

Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas konsultimeve, nënshkruan gjatë këtij viti një marrëveshje bashkëpunimi. Edhe kjo marrëveshje gjen mbështetje në rekomandimet e pasqyruara në Rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë, për të dy institucionet tona, si dhe nxit procesin e informimit konstant të publikut. Marrëveshja synon të forcojë dhe përmirësojë praktikën dhe marrëdhëniet mes Autoriteteve përkatëse në garantimin e

të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në fushat ku këto institucione ushtrojnë kompetencat e tyre ligjore. Veçanërisht, marrëveshja synon përmirësimin dhe konsolidimin e procesit të komunikimit me opinionin publik në fushat e të drejtës për informim, atë të mbrojtjes së të dhënave personale, por edhe në rritjen e transparencës së punës të funksionarëve publikë, në detyrimin e tyre për deklarimin e pasurisë dhe shmangien e konfliktit të interesave.

Marrëveshje Bashkëpunimi mes KDIMDP e QKR dhe KDIMDP e QKL

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nënshkroi dy marrëveshje bashkëpunimi, respektivisht me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe me Qendrën Kombëtare të Licencimit. Këto dokumenta përcaktojnë modalitete të qarta për koordinimin e punës mes zyrës së Komisionerit me QKR-në dhe QKL-në, në procesin e monitorimit të zbatimit të akteve ligjore në fushat respektive. Marrëveshjet bazohen në procesin e bashkëpunimit institucional, me qëllim fuqizimin e procesit të shkëmbimit të ndërsjellët të informacionit. Nëpërmjet përdorimit të bazës së të dhënave të këtyre dy institucioneve nga Zyra e Komisionerit, u jepet një ndihmë e drejtpërdrejtë të gjitha subjekteve tregtare për respektimin e kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, që në nisje të aktivitetit të tyre, posaçërisht, me përmbushjen e detyrimit për plotësimin e formularit të njoftimit dhe regjistrimin në regjistrin elektronik.

Nga ana tjetër, marrëveshjet parashikojnë asistencë konkrete dhe të vazhdueshme për konsolidimin e programit të transparencës dhe fuqizimin e rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit pranë QKR-së dhe QKL-së, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 119/2014. Zyra e Komisionerit e vlerëson si mjaft të rëndësishme rritjen e transparencës së punës nga këto dy institucione të rëndësishme të administratës shtetërore, pasi bashkëpunimi i strukturuar i punës mes Zyrës së Komisionerit dhe QKR-së e QKL-së, është gjithashtu, kontribut i drejtpërdrejtë në procesin e luftës kundër korrupsionit.

Marrëveshjet parashikojnë gjithashtu, koordinimin dhe bashkëpunimin e punës mes institucioneve tona edhe në aspekte të tilla si, shqyrtimin në mënyrë të ndërsjellët të propozimeve për përmirësime të akteve ligjore në fushat respektive; organizimin e përbashkët të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare që i shërbejnë zbatimit të kuadrit ligjor; zhvillimin e trajnimeve në vijimësi për rritjen e kapaciteteve administrative dhe adoptimin e praktikave më të mira; bashkërendimin e punës në hartimin dhe rishikimin e programeve të transparencës dhe kodeve të etikës; etj.

Publikimi i Vendimeve në faqen online të QKR-së, etj

Marrëveshja ka synuar arritje edhe në një aspekt të rëndësishëm. Ajo mundëson edhe publikimin nga QKR në faqen e saj zyrtare, të subjekteve kontrolluese të cilët janë sanksionuar nga Komisioneri me gjobë, pas shkeljeve të konstatuara, por ekzekutimi i tyre bëhet i pamundur për shkak të ndryshimit të adresave apo mos identifikimit të tyre në terren. Publikimi i vendimit për

një afat të caktuar, përmbush afatin kohor dhe shërben si vënie në dijeni për të vijuar më tej me ekzekutimin e vendimeve.

Gjithashtu, pasaktësia e adresave të kontrolluesve, hera herës ka sjellë si pasojë mos realizimin e inspektimit në zbatim të Urdhrit përkatës të miratuar nga Komisioneri. Në këtë kuadër në disa raste është bashkëpunuar me QKR-në me qëllim evidentimin e selisë së ushtrimit të aktivitetit.

2.14 Raportime

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si anëtare me të drejtë vote në Komitetin Konsultativ (T-PD) ka raportuar pranë këtij të fundit mbi zhvillimet e veprimtarisë së punës së saj për periudhën *maj 2014 - maj 2015*, si dhe mbi *Opinionin “Për përfshirjet tek mbrojtja e të dhënave të mekanizmave për shkëmbime automatike ndër-shtetërore për qëllime administrative dhe të taksave”* miratuar nga T-PD.

Në mënyrë kronologjike është raportuar në Ministrinë e Drejtësisë dhe MIE-së në kuadër të PKIE-së, apo në rastet e kërkuara nga përfaqësues të delegacionit të BE-së.

2.15 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Takimi i 17-të i CEEDPA

Zyra e Komisionerit organizoi në datat 29 dhe 30 prill, në mjediset e Hotel Adriatik në Durrës, Takimin e 17-të të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Evropës Qendrore dhe Lindore - CEEDPA.

Ky takim është event i parë ndërkombëtar që mbahet në Shqipëri nga Zyra e Komisionerit. Në të morën pjesë 16 delegacione nga Polonia, Hungaria, Republika Çeke, Maqedonia, Kosova, Serbia, Bosnjë dhe Hercegovina, Mali i Zi, Sllovakia, Bullgaria, Ukraina, Moldavia, Gjeorgjia, Maroku, Italia, si dhe përfaqësues të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Në punimet e ditës së parë të takimit, autoritetet pjesëmarrëse vendosën unanimisht anëtarësimin me të drejta të plotë të Agjencisë Shtetërore të Mbrojtjes së të Dhënave të Kosovës në këtë Rrjet. Pjesëmarrësit në Takimin e 17-të u njohën gjerësisht dhe shkëmbyen eksperiencë për raste konkrete në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe respektimin e privatësisë, informimin në shkollë, reformat ligjore, zhvillimin e teknologjisë, transparencën e punës së autoriteteve publike dhe bashkëpunimin me sektorin privat.

Takimi i 27-të i Punës për Trajtimin e Praktikave të Veçanta - Case Handling Workshop

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi në shtator, “Takimin e 27-të të Punës për Trajtimin e Praktikave të Veçanta”, i njohur ndryshe si “Case Handling Workshop”.

Në këtë aktivitet, edhe ky më i rëndësishmi i këtij formati dhe që u zhvillua për herë të parë në Shqipëri, morën pjesë përfaqësues nga 18 Autoritete homologe të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, anëtare të Konferencës Evropiane dhe tre delegacione vëzhguese. Të pranishmit në këtë takim, përgjatë dy ditëve të zhvillimit të punimeve të tij, diskutuan dhe ndanë eksperiencat më të mira në nivel teknik në këtë fushë. Pjesë e programit të këtij takimi nuk ishin vetëm prezantimet e punës së Autoriteteve homologe të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, por edhe kontrollues privatë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendin tonë, duke sjellë eksperiencat e tyre më pozitive në këtë drejtim.

Pas përfundimit të organizimit të aktivitetit, Zyra e Komisionerit përgatiti Case Handling Workshop Handbook, dokument përmbledhës i aktivitetit, i cili do të publikohet edhe në faqen zyrtare të Komisionit Evropian.

Marrëdhënia me EUROJUST

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të negociatave për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ka zhvilluar takim me përfaqësuesit e EUROJUST (Agjencia e BE për bashkëpunimin në fushën e drejtësisë) si dhe ka vijuar korrespondencën e saj në përmbushje të rekomandimeve të dhëna.

Është sugjeruar nga ky organizëm përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, përputhshmëria e disa akteve të brendshme të agjencive ligjzbatuese shqiptare me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, etj.

Në këtë drejtim, janë miratuar ndryshimet në udhëzimin e Komisionerit nr. 21, datë 24.09.2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj” si dhe në Vendimin e Komisionerit nr. 3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”. Aktet janë dërguar për botim në Fletore Zyrtare.

Pjesëmarrje në Konferencën Evropiane

Zyra e Komisionerit u përfaqësua në Konferencën Evropiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, organizuar nga Zyra e Komisionerit për Informimin të Britanisë së Madhe (ICO), e cila u zhvillua në datat 18-20 maj. Në këtë konferencë u diskutua gjerësisht për forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional si ndërmjet shteteve, ashtu dhe mes autoriteteve publike e sektorit privat. Në terma praktikë, u trajtuan problematika të mbrojtjes së privatësisë në epokën digjitale. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë gjatë punimeve të ditës së dytë të Konferencës Evropiane me një prezantim në lidhje me përgatitjet e Zyrës së Komisionerit për organizimin e edicionit të 27-të të Seminarit të Trajtimit të Praktikave (Case Handling Workshop), në shtator 2015, në Tiranë. Prezantimi u mbajt gjatë sesionit të hapur në të njëjtin panel me Komisionerin e Mbretërisë së Bashkuar dhe atë të Maqedonisë.

Pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare

Zyra e Komisionerit mori pjesë në punimet e Konferencës së 37-të Ndërkombëtare të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Privatësisë, *nën moton “Të ndërtojmë ura bashkëpunimi - Building Bridges”*. Aktiviteti u zhvillua në datat 26-29 tetor në Amsterdam të Holandës me pjesëmarrjen e më shumë se 700 zyrtarëve dhe të ftuarve ndërkombëtarë. Ky është forumi më i madh dhe më i rëndësishëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në botë, ku shkëmbehet eksperiencë në forcimin e ligjit, rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe prezantimin e praktikave më të mira.

Në këtë Konferencë, Zyra e Komisionerit, për herë të parë që prej anëtarësimit të saj, mori pjesë si kontribuese me prezantime në dy panele shumë të rëndësishme. Në panelin kushtuar rrjetit global GPEN (Rrjeti i Agjencive Ligjzbatuese për Mbrojtjen e Privatësisë), fokusi ishte te bashkëpunimi mes institucioneve homologe, e ku një vëmendje e veçantë iu kushtua marrëveshjes së bashkëpunimit me Autoritetin Italian - Garante per la protezione dei dati personali - dhe inspektimeve të përbashkëta, në aktivitetin mbi edukimin digjital prezantoi eksperiencën e saj në organizimin e konkurseve shkollore, si një mjet shumë efikas në ndërgjegjësimin e grupmoshave të reja mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit merr statusin e vëzhguesit në GP29

Pas aplikimit pranë Sekretariatit të Grupit të Punës së Nenit 29, në Njësinë për Mbrojtjen e të Dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Drejtësisë dhe Konsumatorëve të Komisionit Evropian, për anëtarësimin e Zyrës së Komisionerit në këtë organizëm, në cilësinë e vëzhguesit, jemi njoftuar në datë 27 nëntor nga ky Sekretariat mbi pranimin e Autoritetit tonë si anëtarë në cilësinë e vëzhguesit.

Marrja e statusit të vëzhguesit nga Zyra e Komisionerit është një hap i rëndësishëm në rrugën e integritimit evropian të vendit tonë dhe konfirmon respektimin e standardeve të legjislacionit shqiptar, të hartuar në përputhje me atë të BE-së.

Zyra e Komisionerit anëtarësohet në Grupin Ndërkombëtar të Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacione (Grupi i Berlinit - IWGDPT)

Zyra e Komisionerit aplikoi për anëtarësim në Grupin Ndërkombëtar të Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacione ose siç quhet ndryshe Grupi i Berlinit - IWGDPT dhe më datë 28.10.2015 u konfirmua nga Sekretariati i këtij organizmi (rol i cili luhet nga Komisioneri i Berlinit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Lirinë e Informimit) anëtarësimi i Zyrës së Komisionerit në të.

Ky Grup Pune u themelua në vitin 1983 gjatë Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Privatësisë dhe mbledh dy herë në vit ekspertë të telekomunikacioneve, juristë dhe ekspertë teknikë nga autoritetet e mbrojtjes së të dhënave dhe aktorëve të sektorit të telekomunikacioneve. Dokumentet dhe rezolutat e miratuara prej tij nuk kanë fuqi detyruese, por gjithsesi nxisin organizma të ndryshme sikurse Grupin e Punës së Nenit 29, Komisionin e Privatësisë, Konferencën Ndërkombëtare, etj.

Angazhimi në rrjetin GPEN

Rrjeti GPEN është themeluar në vitin 2007, pas miratimit të “Rekomandimit mbi Bashkëpunimin Ndërkufitar për Zbatimin e Ligjeve të Mbrojtjes së Privatësisë” nga ana e vendeve anëtare të OECD-së (*Organisation for Economic Co-operation and Development* – Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim). Ky rrjet ka për qëllim që të diskutojë aspektet praktike të mbrojtjes së të dhënave personale, të ndajë eksperiencën e praktikave më të mira në këtë fushë, të përpunojë prioritetet për zbatimin e legjislacionit, të asistojë iniciativat e përbashkëta ligjore dhe aktivitetet ndërgjegjësuere mes vendeve anëtare të rrjetit. Për herë të parë autoriteti shqiptar prezantoi rolin dhe punën e tij bashkëpunuese, gjatë takimit të GPEN-it, në kuadër të Konferencës së 37-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë të mbajtur në Amsterdam, ku ndër të tjera informoi më shumë për marrëdhënien me autoritetin homolog italian dhe nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit praktik me këtë të fundit. Kjo marrëveshje është mbështetur nga Rezoluta mbi Bashkëpunimin për Zbatimin e Ligjeve të Mbrojtjes së Privatësisë, të miratuar gjatë Konferencës së 36-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë të mbajtur në Mauritius, në 2014-ën.

Procedura për certifikimin e Shqipërisë si vend me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit ka nisur procedurat ligjore për depozitimin e praktikës së plotë pranë Komisionit Evropian për t’u renditur në vendet me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, nëpërmjet vendimmarrjes së këtij organizmi. Arritja e këtij objekti lehtëson dhe standardizon shkëmbimin e të dhënave personale në nivel kombëtar me vendet e BE-së.

Mbështetje e Instrumentit TAIEX

Është shfrytëzuar instrumenti TAIEX në shkëmbimin e eksperiencave me autoritetet homologe. Në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale bashkëpunimi është realizuar me Autoritetin Çek, ndërsa në fushën e të drejtës për informim është realizuar me Komisionerin e Informimit të Skocisë.

3. NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK

Njoftimi dhe Konsultimi publik është pjesë e veprimtarinë së punës së Komisionerit, pas miratimit të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

- Janë trajtuar 2 ankesa.

Konstatohet se nga ana e autoriteteve publike nuk zbatohet procedura e parashikuar në këtë ligj për të njoftuar dhe konsultuar publikun dhe palët e interesuara projektaktet e hartuara, përpara miratimit të tyre. Në kuptim të nenit 21 të këtij ligji, kjo situatë bën të vështirë procedurën e shqyrtimit të ankesave nga ana e Zyrës së Komisionerit.

4. MENAXHIMI BUXHETOR

4.1 Menaxhimi i burimeve njerëzore

Me vendimin nr 106, datë 18.12.2014 të Kuvendit, u miratua struktura e re për Zyrën e Komisionerit në të cilën u integrua edhe e drejta për informim. Gjatë vitit 2015 nga Njësia Përgjegjëse u kryen procedurat përkatëse për plotësimin e organikës si dhe vlerësimet e punës konform ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësit civil” i ndryshuar.


4.2 Menaxhimi financiar

Në këtë vit raportimi, Zyrës së Komisionerit iu akordua një buxhet prej **65.800 (në mijë lekë)**, i cili krahasimisht me vitin 2014 u rrit për afro 50 %, duke u konsideruar edhe si buxheti më i madh në të gjithë veprimtarinë 6 vjeçare të saj .


Fuqizimi, konsolidimi, zhvillimi, prioritetet dhe pritshmëritë e veprimtarisë bënë që ky buxhet me miratimin e Akteve Normative të pësonte ndryshime, duke kapur kështu shifrën e **69.350 lekë (në mijë lekë)**.

Buxheti i akorduar ka përmbushur mbështetjen logjistike e infrastrukture të ushtrimit të kompetencave dhe funksioneve të Zyrës, forcimin e kapaciteteve administrative për monitorimin e të dy ligjeve bazë, koordinimin e punëve me të tretë, ndërgjegjësimin, zhvillimin e përafrimin e kuadrit ligjor në përputhje me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, përfaqësimin e në aktivitete ndërkombëtare apo zhvillimin e aktiviteteve rajonale të arritura për herë të parë në vendin tonë, kryerjen e hetimeve administrative, disiplinimin e kontrolluesve për të përmbushur rekomandimet në ndjekjen e të gjithë procedurave administrative dhe ato gjyqësore, deri në vendosjen e sanksioneve administrative.

Plani 2014



Plani 2015



Respektimi i afateve ligjore të prokurimit dhe financimit, realizoi këtë vit treguesit e performancës institucionale edhe pse fondet ishin shumë herë më të mëdha në numër projektsh si dhe në vlerë.

Në zbatim të procedurave konkurruese, buxheti i akorduar sipas projekteve, për shpenzimet kapitale, i ndryshuar, u realizua në sasi e në vlerë, në masën 99 %.

TABELA E AKORDIMIT TË BUXHETIT DHE REALIZIMIT

(Transferimet dhe ndryshimet me akte normative)

VITI 2014			000 / lekë		
Nr.	EMËRTIMI	PLAN	% kundrejt totalit	Fakt 12 mujor	% realizimi kundrejt planit vjetor
1	Paga	26.640	61%	24.410	85 %
2	Sigurime shoqërore	4.609	9.8%	3.613	94%
3	Mallra e shërbime të tjera	12.231	26%	12.214	99.8%
4	Investime	1.000	2%	998	99.8. %
5	Transferta te buxhetet familjare	500	1%	320	64 %
6	Kuotizacion	100	0.2%	86	86%
	Totali	47.080	100%	41.941	89 %


VITI 2015			000 / lekë		
Nr.	EMËRTIMI	PLAN	% kundrejt totalit	Fakt 12 mujor	% realizimi kundrejt planit vjetor
1	Paga	29300	42%	29.258	99%
2	Sigurime shoqërore	4700	6.6 %	4.641	99%
3	Mallra e shërbime të tjera	19460	28%	19.044	98%
4	Investime	15500	22%	15.375	99%
5	Transferta te buxhetet familjare	290	0.4%	290	100%
6	Kuotizacion	100	0.2%	100	100%
	Totali	69.350	100%	68.708	99 %

Në këtë vit raportimi, Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi audit me objekt “*Auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*”, për një periudhë 2 vjeçare. Raporti pasqyron vlerësime pozitive, nuk konstaton shkelje dhe dëme financiare, ndërsa lë rekomandime


për zbatimin e masave organizative. Për këtë të fundit Akt-Verifikimi i ushtruar më pas konstatoi përmbushjen e tyre.

- ✓ **Të ardhurat nga vjelja e gjobave** të vendosura në rastet e shkeljeve të zbatimit të detyrimeve ligjore, nga kontrolluesit, janë në shumën **4.598.000 lekë** dhe që derdhen 100% në buxhetin e shtetit.

Në vitin 2014 vjelja e gjobave ka qenë në shumën **949.000 lekë**, çka tregon një rritje me gati 5-fish të tyre gjatë këtij viti.



- ✓ Të dhënat e mëposhtme janë tregues i realizimit buxhetor të dy viteve kalendarike.



5. PROBLEMATIKA

- **Identifikohet ende staf jo i mjaftueshëm i Zyrës së Komisionerit**

- ✓ Zyra e Komisionerit është përpjekur të fokusohet në sektorët problematikë dhe që kanë impakt në jetën e individëve (në cilësinë e subjekteve të të dhënave personale). Pavarësisht përkushtimit për të rritur numrin e inspektimeve, dhe shtrirjen e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, **janë hasur vështirësi në terren për realizimin e inspektimeve, për shkak të stafit të kufizuar në dispozicion.**
- ✓ I njëjti fenomen ka sjellë edhe **ngadalësim të procesit të identifikimit dhe kontaktimit të kontrolluesve.** Për rrjedhojë puna është përqendruar në identifikimin e subjekteve kontrolluese e përpunuese të mëdha, duke synuar kategori të njëjta subjektesh, me qëllim sensibilizimin e menjëhershëm të të gjitha kompanive të cilat ushtrojnë aktivitetin në të njëjtën fushë.
- ✓ Shtimi i kompetencave në të drejtën për informim, ku ndër të tjera kërkohet:
 - monitorimi i vazhdueshëm i programeve të transparencës;
 - monitorimi i regjistrave të koordinatorëve dhe përditësimi i tyre;
 - trajnimi i koordinatorëve të pushtetit vendor si dhe
 - rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë civile.
- ✓ Shtimi i kompetencave edhe sipas ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- ✓ Rritja e numrit të ankesave;
- ✓ Zhvillimet e shpejta teknologjike (zgjatin kohën e realizimit të inspektimeve dhe kërkojnë ekspertizë);
- ✓ Rritja e numrit të proceseve gjyqësore.

- **Identifikohet moszbatimi i nenit 31/1/a i ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”**

Sipas kësaj dispozite, Zyra e Komisionerit është përgjegjëse për dhënien e mendimeve për projektakte ligjore, nënligjore dhe projekte që prekin fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Edhe gjatë këtij viti numërohen disa projektakte ligjore dhe nënligjore të pa dërguara për mendim.

6. SFIDAT PËR VITET 2016 – 2018

Miratim i Strategjisë Institucionale për vitin 2016 -2018 përfshirë edhe analizën e riskut.

Disa janë komponentët ku synojmë të mbështetemi

1. Zhvillimi i kuadrit ligjor

- 1.1 Amendime të ligjit nr. 9887/2008 i ndryshuar sipas Rregullores së re të BE-së.
- 1.2 Amendime të ligjit nr. 119/2014.
- 1.3 Transpozim i Direktivës nr. 2003/98/EC.
- 1.4 Rritje e numrit të dhënies së mendimeve për p/akte ligjore, nënligjore dhe projekte.

2. Monitorimi dhe Hetime administrative në rritje

- 2.1 Monitorim i ligjit “Për të drejtën e informimit”, inspektive në rritje, sondazhe dhe raportime.
- 2.2 Monitorim i ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
- 2.3 Rritje e numrit të inspektiveve me 20% në vit dhe ri inspektiveve me tematikë në sektorë që mbledhin e përpunojnë të dhëna personale me 15% në vit.
- 2.4 Trajtim i ankesave me profesionalizëm.
- 2.5 Monitorim i transferimit ndërkombëtar dhe rritje e numrit të vendimeve.

3. Forcimi i kapaciteteve institucionale

- 3.1 Staf i trajnuar në nivel profesional.
- 3.2 Trajnerë të trajnuar.
- 3.3 Bashkëpunim me ASPA-n.

4. Ndërgjegjësimi

- 4.1 Media faktor kryesor në bashkëpunim.
- 4.2 Publiku faktor i rëndësishëm në diktimin e zbatimit të ligjeve.
- 4.3 Oficerë të mbrojtjes së të dhënave të trajnuar.
- 4.4 Koordinatorë të trajnuar.
- 4.5 Publikimi i Komentarit për të drejtën e informimit.

5. Infrastrukturë moderne

- 5.1 Investime në zhvillimin e infrastrukturës informatike, ndërveprim me të gjithë institucionet publike.
- 5.2 Investime në zhvillimin e infrastrukturës logjistike.

6. Aplikim dhe përfitim projektsh

- 6.1 Përfitim i projekteve për të përafruar dhe implementuar standardet më të mira në tematika të caktuara në të dy ligjet përkatëse.
- 6.2 Implementim në standardin e kërkuar të projektit të binjakëzimit të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe konsorciumit Austri-Gjermani, pjesë e të cilit është dhe Zyra e Komisionerit.
- 6.3 Aplikim për projekte nëpërmjet MIE për IPA/2016, në kuadër të veprimtarisë institucionale.

7. Menaxhimi i Buxhetit

Përmirësimi i sistemit të kontrollit dhe menaxhimit financiar.

FALEMINDERIT

ANEKS Nr.1

➤ **Ligje të cilat nuk janë paraqitur për mendim**

1. Ligji nr.14/2015 datë 26.2.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Islandës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat”;
2. Ligji nr. 42/2015 datë 16.4.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen shoqërore”;
3. Ligji nr. 93/2015 “Për Turizmin”;
4. Ligji nr.103/2015 datë 23.09.2015 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën MLC të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për punën detare”, 2006;
5. Ligji Nr. 99/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
6. Ligji nr. 103/2015 datë 23.09.2015 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën MLC të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për Punën Detare” 2006.
7. Ligji nr. 107/2015 “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara”;
8. Ligji nr. 123/2015 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për Mbrojtjen Shoqërore”;
9. Ligji nr. 130/2015 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për Bashkëpunimin Policor”.

➤ **VKM të cilat nuk janë paraqitur për mendim**

1. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 66, datë 28.1.2015 “Për Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit”;
2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 253, datë 25.3.2015 “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Arabe të Egjiptit, për bashkëpunimin doganor dhe ndihmën e ndërsjellë”;
3. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 254, datë 25.3.2015 “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, për ndihmën e ndërsjellë për parandalimin, hetimin dhe dënimin e shkeljeve doganore”;

4. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 308, datë 8.4.2015 “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit”;
5. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 29.4.2015 “Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorive “B” e “C”, në territorin e Republikës së Shqipërisë”;
6. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 375, datë 6.5.2015 “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të shërbimit/ve të posaçme”;
7. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 573, datë 24.6.2015 “Për Miratimin e Standarteve të Shërbimeve të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve”;
8. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 1.7.2015 “Për Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në fushën e sigurisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”;
9. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 630, datë 15.7.2015 “Për Organizimin, Përbërjen dhe Mënyrën e Funksionimit të Komitetit të Etikës”.

➤ Projekte të cilat nuk janë paraqitur për mendim

1. Projekti online i Komisarariatit Digjital.
2. Projekti “Sistemi Multifunksional i kamerave të trupit për patrullat e Policisë së Shtetit”.
3. Sistemi elektronik i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve e-tax.

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	
Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Viti 2015 – Numri 119	
Tiranë – E premtë 10 korrik 2015	
PËRMBAJTJA	
	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 73/2015, datë 27.2015	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 32/2015, “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për zbatimin e problematikës në resolutën për marrëveshjen midis mashorancës qeverisëse dhe opozitës në Kuvendin e Shqipërisë”
Vendim i Kuvendit nr. 74/2015, datë 27.2015	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 32/2015, “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për zbatimin e problematikës në resolutën për marrëveshjen midis mashorancës qeverisëse dhe opozitës në Kuvendin e Shqipërisë”, si ndryshuar
Rezolutë e Kuvendit datë 27.2015	Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2014...
Udhëzimi i ministrit të Mbrojtjes Sociale dhe Rinisë nr. 20, datë 6.7.2015	Për llogaritjen e të ardhurave individuale për ciklet si përcaktimit të masës së pensionit social...

9 p/ligje të cilat nuk janë paraqitur për mendim pranë Komisionerit tashmë të miratuara dhe botuara në Fletore Zyrtare 2015

9 Akte nënligjore (p/vendime) të cilat nuk janë paraqitur për mendim pranë Komisionerit tashmë të miratuara dhe botuara në Fletore Zyrtare

3 Projekte